

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare

Nr. DEK 626 Prot.

Tiranë, më 3/10 2010

(Lidhemi referojeni në rast përgjigje)

Drejtuar: Z. Bujar NEPRAVISHTA ✓
Kryetar i ERE -s

Për Dijeni: Z. Dritan PRIFTI
Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe
Energjetikës

Tiranë

Subjekti: Aplikim për Çmimin e shitjes së energjisë elektrike të Furnizuesit Publik me Shumicë (KESH sh.a.) për vitin 2011 dhe Çmimin e shitjes së energjisë elektrike të KESH Gen (KESH sh.a.)

I nderuar Z. Kryetar,

Bazuar në Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike si dhe rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga ERE, po dërgojmë pranë Jush, aplikimin për miratimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike për KESH Gen dhe Furnizuesin Publik me Shumicë.

Në aplikimin tonë të bazuar në MT kemi konsideruar që nëpërmjet miratimit të këtyre tarifave, KESH Gen dhe Furnizuesi Publik me Shumicë (KESH-I) duhet të mbulojë të gjitha kostot e realizuara për ushtrimin e aktivitetit normal në funksion të një sherbimi sa më të plotë dhe cilësor.

Në këtë mënyrë, kemi parashtruar kërkesën dhe propozimin tonë, që nga ana juaj të merren vendimet përkatëse, duke bërë të mundur kështu arritjen e objektivave në kuadrin e reformës afatgjatë të tarifave, e cila është e koordinuar me reformat e tjera të sektorit dhe ka për qëllim përfundimtar furnizimin e pandërprerë dhe cilësor me energji elektrike të gjithë konsumatorëve të Republikës së Shqipërisë, me koston më të ulët të mundshme.

Në mbështetje të kësaj kërkesë, bashkangjitur do të gjeni:

- Relacioni sqarues për aplikimin e mësipërm dhe,
- Tabelat e llogaritjeve.

Vendimarrja juaj në lidhje me shqetësimet dhe kërkesat e mësipërme, sa më e shpejtë dhe e drejtëpeshuar të jetë, do të krijojë kushtet e duhura që Objektivat e Qeverisë dhe reformat tashmë të ndërmarra për sektorin elektroenergjetik të realizohen me sukses.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin, jemi në dispozicionin tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Drejtori i Përgjithshëm

Engjell ZEQO



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Zeqo'.

RELACION PËR APLIKIMIN E TARIFAVE PËR VITIN 2011

Po ju paraqesim më poshtë arsyet, hipotezat, agumentat dhe përlogaritjet tona për aplikimin e tarifave të energjisë elektrike për KESH Gen dhe Furnizuesin Publik me Shumicë.

I. QËLLIMI

Ky dokument ka për qëllim të sqarojë dhe argumentojë kërkesën e KESH sh.a. drejtuar Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me tarifat e reja të energjisë elektrike për KESH Gen dhe Furnizuesin Publik me Shumicë për vitin 2011. Tarifat e reja të energjisë elektrike do të krijojnë mundësinë e ushtrimit normal të aktiviteteve të dy prej të licensuarve në tregun shqiptar të energjisë elektrike. Miratimi i drejtë i tyre përbën një kusht të domosdoshëm për përmirësimin e situatës financiare të KESH sh.a. duke bërë që KESH-i të jetë vertet një kompani tregtare që mbulon me burimet e veta të gjithë shpenzimet operative të vitit dhe koston lokale të investimeve dhe i pavarur financiarisht nga Buxheti i Shtetit.

Propozimi ynë për vitin 2011 është mbështetur në reformën afatgjatë të tarifave, e cila është e koordinuar me reformat e tjera të sektorit dhe ka për **qëllim përfundimtar furnizimin e pandërprerë dhe cilësor me energji elektrike të gjithë konsumatorëve të Republikës së Shqipërisë, me koston më të ulët të mundshme.**

Duke qenë se, KESH Gen dhe Furnizuesi Publik me shumicë, janë pjesë e strukturave të KESH sh.a., në materialin e përgatitur, do të trajtohen në të njëjtin dokument por në mënyrë të ndarë, përlogaritjet tona për secilën nga tarifat e kërkuara.

II. HYRJE


Objektivi kryesor i KESH sh.a., në mbështetje të të gjitha reformave të ndërmarra në sektorin e energjisë elektrike dhe zbatimit të politikave të Qeverisë për sektorin elektroenergjetik, ka qenë furnizimi i plotë i konsumatorëve fundorë me energji elektrike, efienca në menaxhimin e burimeve hidrike nëpërmjet shfrytëzimit optimal të të gjitha kapaciteteve gjeneruese duke garantuar harmonizimin e të gjitha aspekteve që lidhen me treguesit e sigurisë së punës së sistemit, cilësinë e shërbimit, koston e tij, si dhe garantimin e produkteve të shërbimeve ndihmëse. Situata financiare e KESH sh.a. rezulton me një akumulim në vite të defiçiteve në likuiditetet e kompanisë, ku një ndër faktorët që ka ndikuar negativisht është edhe pamjaftueshmëria e tarifave të miratuara për të mbuluar shpenzimet operative dhe investimet e kompanisë.

Në kuadrin e zbatimit të Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, rregullave dhe normave të përcaktuara nga institucionet përkatëse; KESH sh.a. është i fokusuar në përbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë që rrjedhin nga këto norma.

Në këtë drejtim për realizimin e objektivave të përcaktuara dhe për ushtrimin e një aktiviteti normal dhe cilësor të shërbimit të furnizimit me energji elektrike është i rëndësishëm një pasqyrim sa më real dhe transparent i tarifave.

III. PARASHIKIMET E BILANCIT ENERGJETIK

Grafiku i mëposhtëm, tregon parashikimet e fluksit të energjisë elektrike për vitin 2011.



KESH Gjenerimi:

Duke marrë në konsideratë, (i) të dhënat statistikore shumëvjeçare të nivelit të liqeneve, prurjeve dhe prodhimit; (ii) optimizimin dhe administrimin e rezervës ujore, është parashikuar që për vitin 2011, prodhimi i KESH Gjenerimit të jetë në nivelin 4,271 GWh.

Gjithashtu, është parashikuar dhe një balancë neto e shkëmbimit efekti i së cilës është zero.

Energjia e disponueshme e KESH Gjenerimit, për mbulimin e humbjeve të OST sh.a. dhe furnizimin e FPSH është parashikuar përkatësisht 220 GWh për mbulimin e humbjeve të OST dhe 4,051 GWh për FPSH.

FPSH:

Duke u nisur nga kërkesa me e fundit zyrtare e ardhur nga OSSH sh.a., për energjinë e nevojshme për konsumatorët fundorë, janë bërë parashikimet për mbulimin e kësaj kërkesë nga ana e FPSH. Kështu, duke u nisur nga kërkesa prej 4,553 GWh, është parashikuar dhe mbulimi i plotë i kësaj energjie: 4,051 GWh nga KESH Gjenerimi; 246 GWh nga TEC Vlorë; 165 GWh nga HEC privatë dhe koncesion; diferenca prej 91 GWh energji elektrike është parashikuar të mbulohet me import.

TEC Vlorë:

Për vitin 2011, TEC Vlorë është parashikuar të prodhojë një sasi energjie prej 246 GWh në mënyrë që të shmanget çdo anomali e mundshme në sigurimin e energjisë elektrike për plotësimin e nevojave të konsumatorëve fundorë.

IV. TARIFA E KESH GEN.

Përlogaritjet e tarifës së KESH GEN, janë bërë duke konsideruar parashikimet më të fundit të treguesve tekniko financiar të KESH Gen për vitin 2011, duke marrë në konsideratë metodologjinë e përlogaritjes së tarifës për KESH GEN.

Kështu duke ju referuar parashikimit për prodhimin e energjisë elektrike nga KESH GEN; parashikimeve për kostot operative dhe kapitale të domosdoshme për funksionimin normal të aktivitetit të KESH GEN; treguesve të tjerë referuar metodologjisë, nga përlogaritjet e bëra, tarifa e kërkuar për KESH GEN për vitin 2011, rezulton të jetë 1.12 lekë/kWh nga 0.4 lekë/kWh që është aktualisht.

Të ardhurat e realizuara nga eksporti i energjisë elektrike gjatë vitit 2010, janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për detyrimet ndaj Ministrisë së Financave dhe një pjese të Overdrafteve të marra nga Bankat e nivelit të Dytë, të marra për blerjen e importit gjatë viteve 2007-2008. Krahas asaj çfarë është paguar, mbetet akoma një detyrim prej rreth 83 mln EUR, detyrim i cili është parashikuar të shlyhet sipas hipotezave brenda 2 viteve ose brenda 1 viti, duke konsideruar edhe mundësinë e krijuar nga fondet e eksportit të cilat në formën e një linje kredie egzistuese nga bankat të mund të përdoren në formën e një "Fondi Balancimi" për të përballuar kosto shtesë të blerjeve të energjisë në periudha jo të mira hidrike.

Në mënyrë më të detajuar do të gjeni tabelën bashkëlidhur.

B. TARIFA E FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË

Përlogaritjet e tarifës së FPSH, janë bërë bazuar mbi parashikimet më të fundit të treguesve tekniko-financiarë të FPSH-së për vitin 2011, duke marrë në konsideratë metodologjinë e përlogaritjes së tarifës për FPSH-në.

Tarifa e nevojshme për FPSH-në, është përlogaritur duke konsideruar dy skenarë për të cilët duhet të gjykohet në mënyrë racionale nga ana e institucioneve përkatëse, në mënyrë që të konsiderohet ecuria normale e aktivitetit të KESH sh.a.

Këto skenarë konsistojnë në trajtimin e mënyrës së shlyerjes së OVERDRAFT-eve të marra nga KESH sh.a. për pagesat e importit të energjisë elektrike gjatë viteve 2007-2008, të cilat pas rinovimeve të herëpashershme, janë të pagueshme gjatë vitit 2011. Në këtë mënyrë, janë konsideruar hipotezat e shlyerjes brenda 2 viteve dhe të shlyerjes brenda 1 viti.

Duke marrë në konsideratë kostot e blerjes së energjisë nga KESH Gen; energjisë së blerë nga HEC Private dhe Konçesion (duke marrë parasysh tarifën aktuale të tyre); kostot fikse të TEC Vlorë si dhe kosto të tjera operative të domosdoshme për aktivitetin normal të tyre, tarifa e nevojshme për FPSH-ne, për vitin 2011 është 3.97 leke/kWh sipas skenarit të parë dhe 5.31 leke/kWh sipas skenarit të dytë nga 2.03 lekë/kWh që është aktualisht.

Në mënyrë më të detajuar do të gjeni tabelën bashkëlidhur.

Në gjykimin e KESH sh.a., tarifa e nevojshme për FPSH-në, për vitin 2011, duhet të jetë 5.31 lekë/kWh.



Bilanci energjetik i KESH sh.a. per Vitin 2010 dhe parashikimi per vitin 2011 (ne MWh)

KESH sh.a.	PRODHIMI	Index	2009	VITI 2010		Viti 2010 I prishimi	2011
				6 Mujori i Pare			
				Plan	Fakt		
KERKESA PER ENERGJI NGA OSSH sh.a.							
	Produktimi Bruto	A	4,279,937	2,102,000	2,216,000	4,378,000	4,553,000
	Produktimi Hidro (Kaskadat)	B = 1+2+3	5,140,308	3,191,035	4,466,100	3,884,996	4,318,503
	Produktimi Hidro (mesem dhe te vegjel)	1	5,070,118	3,152,283	4,425,358	3,767,803	4,250,503
	Produktimi Termal	2	70,190	39,652	40,742	37,133	68,000
	Konsumi Vetjak	3	0	0	0	0	0
	Humbjet ne Prodhim	4	4,822	9,578	6,310	5,945	12,711
	Produktimi Neto	5	23,782	25,541	17,748	15,854	33,602
	Dhene/Export	C = B - 4 - 5	5,111,704	3,156,816	4,442,041	3,783,197	4,271,319
	Marrje	D	618,295	975,448	2,117,666	0	200,000
	Shpenzimi	E	141,361	22,726	75,879	40,989	116,666
	Balansa (Marrje - Dhene)	F = E - D	-476,838	-952,721	-2,041,787	40,989	-2,000,798
	Injektuar ne rrjetin e Transmetimit	G	5,226,633	3,139,890	4,478,106	1,787,053	4,403,319
	Injektuar ne rrjetin e Shpërndarjes	H	79,496	39,652	38,815	37,133	69,000
	Produktimi Bruto	6	870	0	27,345	218,207	245,552
	Konsumi Vetjak dhe humbjet	7	1,024	0	0	0	7,594
	Produktimi Neto	I = 6 - 7	-154	0	27,345	218,207	245,552
	Produktimi nga Impjantet me Koncesion dhe Private	J	89,310	57,860	87,944	82,031	149,275
	Totali i Produktimit neto Vendas	K = C + I + J	5,200,860	3,214,376	4,557,330	2,063,435	4,881,536
	Humbjet ne Transmetim	L	211,180	99,054	141,921	100,346	242,267
	Energji nga Impjantet me Koncesion dhe Private	= J	89,310	57,860	87,944	82,031	149,275
	Energji nga TEC Vlore	= I	-154	0	27,345	218,207	245,552
	Energji nga KESH Gen.	M = G + H - L - D	4,137,717	2,104,440	2,258,333	1,773,840	4,051,319
	Energji nga IMPORTI	N	53,064	0	0	300	91,464
	ENERGJIA E SHITUR NGA FPSH	O = J + I + M + N	4,279,937	2,162,000	2,373,621	2,004,379	4,378,000
	ENERGJIA E SHITUR per Konsumatoret Fundore	PER OSSH sh.a.	4,279,937	2,162,000	2,373,621	2,004,379	4,378,000
	PER Kliente te tjere	PER Kliente te tjere	0	0	0	0	0
	ENERGJIA E SHITUR nga KESH Gen. TEK OSSH sh.a. per Humbjet		265,669	0	0	0	0
	ENERGJIA E SHITUR PER HUMBJET NE TRANSMETIM		211,180	99,054	141,921	100,346	242,267
	ENERGJIA E SHITUR EKSPORT		975,448	2,117,666	0	2,117,666	220,000
	ENERGJIA BALANCOUSE PER OST		0	-1,870	0	-1,870	0
	ENERGJI NGA KESH PER MBULIMIN E HUMBJEVE TE OSSH		0	211,621	-211,621	0	0

E GJENERIMIT

2009 2010 2011

STO E KAPITALIT	2,357.4	2,084.1	2,124.8
LERA E ASETEVE (Bruto)	33,677.0	35,699.0	37,567.0
Amortizimi i Akumuluar	5,644.4	6,404.0	7,233.0
Vlera e ASETEVE (Neto)	28,032.6	29,295.0	30,334.0
Investime ne proces			
Investimet e Vitit	314.0	2,022.0	1,868.0
Amortizimi i Vitit	759.6	829.0	879.0
3aza e Rregulluar e Aseteve (RAB)	27,587.0	30,488.0	31,323.0
= RAB norma e kthimit	5.8%	4.1%	4.0%
ROE	13.2%	6.2%	4.5%
- Fitimi Neto (para taksave)	2,417	1,136	823
- Kapitali i vet	18,322.0	18,322.0	18,322.0
- Huate afatgjata	26,334.0	24,101.0	21,728.8
Huate Afatgjata/Asetet fikse	85.9%	73.8%	64.2%
Interesat per huate afatgjata	1,325.53	889.00	889.00
Detyrimet per huate afatgjata ne fillim te vitit	28,940.0	26,334.0	24,101.0
= norma mesatare e interesit e kredive afatgjata	4.6%	3.4%	3.7%
THIMI I KAPITALIT	1,598	1,255	1,246
Amortizimi i Vitit	759.6	829.0	879.0
Costo e tatim Fitimit	241.7	113.6	82.3
KAPACITETI PRODHUES	1,130	1,130	1,130
Costo Totale e Kapacitetit	2,599.1	2,197.7	2,206.9
KAPACITY CHARGE (Mln Lek/kW per muaj)	0.19	0.16	0.16
KARIFA E ENERGJISE			
Costo e Mirembajtjes	144.6	256.0	275.7
Costo e Personelit	837.7	1,115.0	1,170.4
Costo e Furniturave, shorbimeve etj	814.1	940.0	1,139.0
Karifa Totale e Energjise	1,796.4	2,311.0	2,585.0
Costo Totale e Kapacitetit	2,599.1	2,197.7	2,206.9
ENERGJI E PRODHUAR (GWh)	5,111.7	6,225.2	4,271.3
KARIFA E ENERGJISE (Lek/kWh)	0.35	0.37	0.61
KARIFA E KAPACITETIT (Lek/kwh)	0.51	0.35	0.52
KOSI MIMESATAR (kapacitet + energji) (Lek/kWh)	0.86	0.72	1.12

SKENARET E TARIFAVE TE NEVOJSHME PER FPSH PER VITIN 2011

Nr.	EMERTIMI	Njesia	2010	2011	
				TEC Vlore prodhim	TEC Vlore prodhim
				ODR	ODR paguar
1	Kerkesa per Energji nga OSSH	GWh	4,378	4,553	4,553
2	Produhmi i Energjise nga KESH Gen.	GWh	6,225	4,271	4,271
	Produhmi Hidro ne Kaskadat	"	5,147	4,203	4,203
	Produhmi Hidro nga implantet e Vogjel	"	78	68	68
3	Humbjet ne Transmetim	GWh	242	220	220
4	Energji nga KESH Gen per Shitje	GWh	5,983	4,051	4,051
	Per FPSH-ne	"	3,982	4,051	4,051
	Per Humbjet e OSSH	"	0		
	Per Eksport dhe/ose Shkambim	"	2,001	0	0
5	Mbulimi i Kerkeses nga FPSH	GWh	4,378	4,553	4,553
	PVE dhe PPE	"	150	165	165
	TEC-et	"	246	246	246
	Nga Produhmi i KESH Gen.	"	3,982	4,051	4,051
	Importi	"		91	91
6	Tarifa mesatare e KESH Gen.	Leke/kWh	0.40	1.12	1.12
7	Tarifa Mesatare e Exportit	"			
8	Celimi mesatar i Importit	"	5.39	6.97	6.97
9	Celimi i PVE & PPE	"	7.19	6.89	6.89
10	Kosto Mesatare e Energjise nga TEC	"	19.80	19.80	19.80
11	Tarifa e FPSH-se	Leke/kWh	2.03	2.71	2.71
Te ardhurat dhe Shpenzimet					
12	TE ARDHURAT				
	Te ardhura nga shitja e energjise OSSH-se	Milione Leke	8,887	12,353	12,353
	Te ardhura nga shitja per humbjet e OST	"			
	Te ardhura nga Shitjet e Exportit	"			
	Te ardhura te Tjera OpFis	"			
	Totali i te ardhurave	Milione Leke	8,887	12,353	12,353
13	SHPENZIMET				
	Blerje Energjise Importe	Milione Leke	0	637	637
	Blerje Energjise Nga KESH Gen	"	1,593	4,545	4,545
	Blerje Energjise nga PPE&PVE	"	1,065	1,135	1,135
	Blerje Energjise nga TEC	"	4,862	4,862	4,862
	Kosto Personel	"	30	32	32
	Materialte dhe Mirëmbajtje	"	2	2	2
	Furnitura	"	7	6	6
	Interesat	"	837	772	772
	Amortizimi	"	0	0	0
	Provizionet	"	0	0	0
	Totali i Shpenzimeve	Milione Leke	8,396	11,993	11,993
14	Rezultati para Taksave	Milione Leke	491	360	360
15	Tatim Fitimi	Milione Leke	49	36	36
16	Fitimi/Humbja e vitit	Milione Leke	442	324	324
CASH-FLOW					
17	EBAD (Cash nga Aktiviteti Operativ)	Milione Leke	442	324	324
18	% e arketimit te Futures	%	100%	100%	100%
19	Investimet	Milione Leke		1	1
20	Llogarit te Arketueshme	"	0	0	0
21	OVERDRAFT	"	6,650	5,480	10,960
	Aratgates	"			
	OVERDRAFT	"	6,650	5,480	10,960
22	Cash Flow Para Financimit	Milione Leke	-6,408	-5,157	-10,637
23	Hua AfatShkurter/Overdraft	Milione Leke	0	0	0
24	Hua nga GoA	"	0	0	0
25	Te Prapambetura nga GoA	"	0	0	0
26	Subvencion nga GoA	"	0	0	0
27	Cash Flow i Vitit	Milione Leke	-6,408	-5,157	-10,637
TARIFA E NEVOJSHME PER FPSH		Leke/kWh	3.66	3.97	5.31

kanal